



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT

PLANI STRATEGJIK

2024-2026

Dhjetor, 2023



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikatat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik

PËRMBLEDHJE.....	6
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SEKTORIT TË UJIT DHE KORNIZA LIGJORE.....	8
1.1 Organizimi institucional i sektorit të ujit në Kosovë	8
1.2 Korniza ligjore e aplikueshme në sektorit e ujit në Kosovë	9
1.3 Roli dhe përgjegjësitë e ARRU.....	10
2. KORNIZA E PLANIT STRATEGJIK.....	13
2.1 Synimet dhe objektivat strategjike	13
3 MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT	17
4 BUXHETI PËR OPERIM TË ARRU-së	28
5 MENAXHIMI I RISKUT, FAKTORËT E SUKSESIT DHE MONITORIMI	29
5.1 Faktorët e suksesit	36
5.2 Monitorimi	36

LISTA E SHKURTESAVE

- ARRU – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
- BD – Bordi i Drejtorëve të KRU-ve
- IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
- IAWD – Shoqata Ndërkombatare e Ujit të Danubitt
- IBNET – Rrjeti Ndërkombëtar i Bechmarkingut
- NJPMNP – Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
- Nj-I – Njësia për inspektim
- KNMU – Këshilli Ndërministror për Ujërat
- ME – Ministria e Ekonomisë
- MIE – Ministria e Integritimeve Evropiane
- MEF – Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- MTIN – Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë
- KRU – Kompanitë Rajonale të Ujësjetësimit
- KK – Komisioni Funkcional Parlamentar i Kuvendit të Kosovës
- KZA – Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave
- UPF – Uji i Pa Faturuar
- PMA – Plani i menaxhimit të aseteve
- PB – Plani i Biznesit
- D-ÇL&L – Departamenti për çështje ligjore dhe licenca
- D-P – Departamenti për performancë
- D-AF – Departamenti për administratë dhe financa
- D-T – Departamenti për tarifa
- DANUBIS – Programi i Bechmarkingut të Vendeve të Regjionit të Danubit
- ERRU – Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë
- QK – Qeveria e Kosovës
- GNI – Grupi Ndërinstitucional i themeluar nga KNUMU
- GIS – Sistemi informativ gjeografik
- SCO – Zyra Zvicerane për Zhvillim

SHUKOS – Shoqata e Ujësjesve dhe Kanalizimeve të Kosovës

SKZH – Strategjia kombëtare për zhvillim

ZD – Zëvendës Drejtori i ARRU

ZMP – Zyrtar për Marëdhënie me Publikun

WAREG – Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit

PËRMBLEDHJE

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive të dhëna me Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU përmes Planit Strategjik 2021 -2023 ka përcaktuar synimet të cilat do të jenë udhërrëfyese për planifikimin dhe punën e ARRU për periudhën e ardhshme tri vjeçare. Plani është në përputhje me kornizat kryesore të zhvillimit kombëtar siç janë: Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025 (kapitulli 2.12.3 që flet për menaxhimin e ujërave dhe ngritjen e infrastrukturës), Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Strategjia Shtetërore të Ujërave në Kosovë, si dhe dokumentet tjera relevante.

Angazhimi i ARRU për përmbushjen e synimeve të parapara në Plan për periudhën tri vjeçare, përmes veprimeve të zbërthyer më tej në planet e vjetore të punës, ka për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve të ujit. Në Planin Strategjik 2024 – 2026 ARRU ka definuar 6 synime strategjike, përmes të cilave do të përmbushë mandatin e saj ligjor për të siguruar që ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit të ofrojnë “shërbime cilësore, të sigurta, efçente dhe jo diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë”.

- **Korniza ligjore dhe rregullative është në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe e balancuar me kërkesat e konsumatorëve**

ARRU, si autoritet i pavarur rregullator, vlerëson se korniza ligjore duhet të jetë e qartë dhe e zbatueshme, e cila duhet të vendosë balancë midis të drejtave dhe përgjegjësive të konsumatorëve dhe të ofruesve të shërbimeve. Definimi i qartë i obligimeve të ndërsjellta të palëve, licencimi dhe vendosja e kriterëve të licencimit vendos rregull dhe siguron nivel më të lartë të shërbimeve të ujit.

- **Menaxhimi dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e infrastrukturës së shërbimeve të ujit sigurohet përmes procesit tarifor**

Parimi kryesor në zbatimin e obligimeve ligjore rregullatore është që përmes procesit tarifor të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të mund të gjenerojnë të hyra të mjaftueshme për të financuar siç duhet aktivitetet e tyre, në përputhje me nivelin standardeve të shërbimit, të balancuara kundrejt sigurimit që konsumatorët të paguajnë jo më shumë se sa është e nevojshme, që konsumatorët e cenusshëm të jenë në mënyrë adekuate të mbrojtur duke marrë parasysh edhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e publikut.

- **Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimeve kundrejt caqeve të aprovuara, udhëhequr në praktikë e benchmarkingut dhe konkurrencës**

Monitorimi dhe vlerësimi kritik i performancës së ofruesve të shërbimeve është një prej përgjegjësive funksionale të ARRU. Në këtë kontekst ARRU ka definuar një numër të treguesve kyç të performancës (TKP) për të analizuar dhe rishikuar performancën e ofruesve të shërbimit, për të krahasuar performancën e ofruesve të shërbimit mes vete në Kosovë dhe më gjerë dhe për të matur progresin e arritur kundrejt objektivave të përcaktuara/ caqeve të vendosura. TKP janë mjete vlerësimi që mundësojnë autoriteteve rregullatore të vlerësojnë performancën e ofruesve të shërbimit.

- **Monitorimi dhe inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe besueshmërisë së të dhënave**

Inspektimi i rregullt i ofruesve të shërbimeve për përmbushje të standardeve të shërbimit sipas kushteve të licencës është mekanizmi kryesor përmes të cilit ARRU sigurohet që shërbimet e

ofruara për konsumatorët janë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe detyron ofruesit e shërbimeve të mirëmbajnë standardet minimale të shërbimit në çdo moment.

- **Nxitja e zhvillimit institucional të ARRU-së, mirëmbajtja dhe krijimi i partneritetit për t'u përballur me sfidat në rritje të sektorit**

ARRU, ka si prioritet mbështetjen e stafit për të marrë pjesë në trajnime në fushat që janë me interes për shërbimet e ujit, si: aspektet ligjore të rregullimit të shërbimeve të ujit, monitorimi i standardeve të shërbimeve, monitorimi i performancës, përcaktimi i tarifave. Pjesëmarrja në trajnime dhe ngritja profesionale e stafit është thelbësore për zhvillimin e institucionit të ARRU-së.

- **Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU**

Mbështetja e funksionimit dhe monitorimi i brendshëm i ARRU-s si institucion duke përkrahur departamentet dhe njësinë në ARRU në aspektet administrative, financiare, materiale dhe logjistike në arritjen e synimeve dhe objektivave të parapara me ligj. Kordinimi i veprimeve të ARRU-së me Ministrinë e Administratës Publike për sa i përket burimeve njerëzore dhe çështjeve të tjera relevante, bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SEKTORIT TË UJIT DHE KORNIZA LIGJORE

1.1 Organizimi institucional i sektorit të ujit në Kosovë

Në aspektin institucional, sektorit të ujit në Kosovë është i organizuar si në vijim:

- (i) **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI)** - është institucioni përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e burimeve të ujit, përfshirë hartimin e kornizës ligjore dhe dokumenteve të tjera strategjike zhvillimore (strategjitë dhe planet) për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e burimeve të ujit. Në këtë kuptim, në kuadër të MMPHI, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (DMMU) është përgjegjës për hartimin e kornizës ligjore për administrimin dhe menaxhimin e ujërave, ndërsa Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) është përgjegjës për hartimin e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore që rregullojnë zhvillimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të ujit në tërë territorin e Kosovës. Përderisa Departamenti për Inspektimin e Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjës për të monitoruar cilësinë e ajrit, ujit, dheut, natyrës, emisionit dhe kushteve të përgjithshme ekologjike, përfshirë zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi.
- (ii) **Ministria e Ekonomisë (MeE)** - përmes Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP), është përgjegjëse për monitorimin e operimit të ndërmarrjeve publike ku Qeveria e Kosovës është aksionare e vetme e këtyre ndërmarrjeve. Në grupin e ndërmarrjeve publike përfshihen edhe ofruesit e shërbimeve të ujit - Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU). NjPMNP është përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndërmarrjeve publike konform parimeve të njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike.
- (iii) **Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)** - është institucion i pavarur për rregullimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të ujit (ujit të pijshëm, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë) që nënkupton: licencimin e ofruesve të shërbimit (KRU-të), përcaktimin e tarifave për shërbimet e ujit, përcaktimin e standardeve të shërbimit dhe inspektimin e zbatimit të këtyre standardeve, monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimit dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve. Pra, ARRU është ligjërisht e mandatuar të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efiçente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.
- (iv) **Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK)** - është autoriteti përgjegjës që organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat shëndetësisë publike në Kosovë. IKSHPK, është përgjegjëse për të koordinuar me ofruesit e shërbimeve të gjitha çështjet lidhur me kualitetin e ujit të pijes dhe zbaton monitorimin operacional dhe të përputhshmërisë të cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor.
- (v) **Komunat** - janë kompetente për ofrimin e shërbimeve publike të furnizimit me ujë dhe të mbeturinave. Kjo kompetencë e tyre në rastin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura realizohet përmes Marrëveshjeve të Shërbimit që komunat nënshkruajnë me KRU-të perkatëse dhe përmes përfaqësimit të përfaqësuesve të komunave në Bordet e Kompanive Rajonale të Ujit (sipas Ligji Nr. 04/L-111), që prezantojnë interesat dhe kërkesat e komunave ndaj KRU-ve.

1.2 Korniza ligjore e aplikueshme në sektorin e ujit në Kosovë

Siç u potencua më lartë, institucionet kryesore që rregullojnë sektorin e ujit janë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), që është përgjegjëse për menaxhim të burimeve të ujit, Ministria e Ekonomisë (MeE), që është aksionare e vetme e Kompanive Regjionale të Ujit (KRU) që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të ujit në Kosovë dhe ARRU që është rregullatorë ekonomik dhe licencon KRU për ofrimin e shërbimeve të ujit. Korniza ligjore e aplikueshme në Kosovë që rregullon shërbimet e ujit është listuar në vijim:

- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, përfshirë të gjitha udhëzimet administrative që derivojnë nga ky ligj dhe që rregullojnë fushën e menaxhimit të burimeve të ujit.
- Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, Ligjin Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, përfshirë udhëzimet administrative që derivojnë nga ky ligj.
- Ligji Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjit nr. 06/I - 088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/I-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, përfshirë rregulloret që derivojnë nga ky ligj që janë hartuar nga ARRU.
- Ligji për Shëndetësi Publike Nr. 02/L-78 dhe Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.
- Ligji Nr. 03/I-040 për vetëqeverisjen lokale.

1.3 Roli dhe përgjegjësitë e ARRU

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjit nr. 06/l – 088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU ka për detyrë rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Përgjegjësitë kryesore funksionale të ARRU janë përshkruar si në vijim:

- (i) Licencojë ofruesit e shërbimeve dhe të mbikëqyrë zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit në mënyrë që të mbrojnë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë që tregu të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe brenda kuadrit ligjor;
- (ii) Përcaktojë tarifën e ofruesit të shërbimeve të ujit të pijshëm, ujërave të ndotur dhe ujit me shumicë, duke siguruar që tarifën të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- (iii) Vendos standardet e shërbimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve të ujit;
- (iv) Monitorojë performancën e KRU, duke i nxitur dhe inkurajuar për të ngritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë operative dhe financiare;
- (v) Zgjidhë ankesat e konsumatorëve, për të cilat konsumatori pretendon se ofruesi i shërbimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi;
- (vi) Inspektojë përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;
- (vii) Hartojë dhe miratojë rregullore dhe vendime rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr. 05/L-042 dhe Ligjit Nr. 06/l -088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

1.1 Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit nga ARRU

Rregullimi i shërbimeve të ujit realizohet përmes Licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotur, të cilët operojnë në zonat e tyre përkatëse të shërbimit. ARRU ka licencuar 7 Kompani Regjionale të Ujit (KRU) dhe 1 kompani për furnizim të ujit të papërpunuar me shumicë që është NHE Ibër-Lepenci. Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bërë në vitin 2018 në kohëzgjatje prej 8 vitesh, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042 si dhe Rregulloren Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.


Kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve të ujit në Kosovë janë:

- KRU “Prishtina” Sh. A. ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë.
- KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamushë.
- KRU “Hidrodrini” Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.
- KRU “Mitrovica” Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtrri. KRU “Mitrovica” ofron ujë të trajtuar me shumicë për komunat në pjesën veriore të Kosovës, por duke qenë se këto komuna nuk janë të integruara nën menaxhimin e KRU “Mitrovica”, sistemet e furnizimit me ujë e këtyre komunave nuk operohen dhe nuk mirëmbahen nga KRU “Mitrovica”, e as konsumatorët nuk faturohen dhe nuk ka arkëtim për ujin që shpërndahet në këto komuna.


-
- KRU “Gjakova” Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe 10 fshatra të komunës së Prizrenit.
 - KRU “Hidromorava” Sh.A. ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti. Komuna e Novobërdës, Parteshit dhe Ranillugut janë pjesërisht të integruara nën strukturat menaxhuese të KRU Hidromorava, ndërsa komuna e Kllokotit nuk është fare e integruar.
 - KRU “Bifurkacioni” Sh.A. ofron shërbimet në komunën: Ferizaj, Kaçanik dhe një pjesë të territorit të komunës së Hanit të Elezit. Komuna e Hanit të Elezit është në proces të integritimit nën menaxhimin e KRU Bifurkacioni, ndërsa komuna e Shtërpçës nuk është ende e integruar.
 - Ndërmarrja Hidro Ekonomike (NHE) “Ibër-Lepenci” Sh.A. është kompania e vetme e licencuar për ofrim të shërbimeve të ujit me shumicë dhe furnizon ujë të papërpunuar me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.

Përveç shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) të licencuara dhe që ofrojnë shërbimet e ujit në mënyrë ligjore në Kosovë, në disa komuna dhe vendbanime rurale furnizimi i qytetarëve me ujë është i organizuar përmes “ndërmarrjeve komunale” apo rastet kur komuniteti (zonat rurale) kanë angazhuar një “operator” (person fizik) për mirëmbajtje dhe operim të sistemeve rurale. Në të dy rastet ofrimi i shërbimeve bëhet nga entitete të pa licencuara. Në këtë grup bëjnë pjesë kryesisht komunat: Leposaviç, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçe, Mitrovica e Veriut dhe Kllokoti.


Zona e shërbimit të KRU-ve dhe mbulueshmëria me shërbime - Viti 2022



Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit



Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit



2. KORNIZA E PLANIT STRATEGJIK

2.1 Synimet dhe objektivat strategjike

ARRU ka definuar 6 synime strategjike, që reflektojnë strukturën ekzistuese organizative të ARRU-së, të grupuara sipas përgjegjësi të departamenteve dhe njësisë së institucionit të ARRU. Në kuadër të secilit synim strategjik janë definuar/ formuluar objektivat përkatëse. Aktivitetet e detajuara për secilën objektive, përfshirë planin kohor të zbatimit dhe treguesit e matjes, janë përmbledhur në matricën e planit të veprimit në kapitullin 3.

Synimi Strategjik 1: Korniza ligjore dhe rregullative është në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe e balancuar me kërkesat e konsumatorëve

Në kuadër të këtij synimi strategjik janë definuar 3 objektiva si në vijim:

- Objektiva 1: Korniza ligjore dhe rregullatore kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit
- Objektiva 2: Monitorimi dhe zbatimi i politikave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve
- Objektiva 3: Monitorimi i zbatimit të kushteve të licencës të ofruesve të shërbimeve të ujit

ARRU është institucion i pavarur dhe i paanshëm, përgjegjës për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore që kanë për qëllim rregullimin e shërbimeve të ujit, përcaktimin e standardeve të shërbimit. ARRU angazhohet për rishikimin e vazhdueshëm të infrastrukturës ligjore dhe rregullatore, me qëllim të krijimit të një kornize ligjore të avancuar, të qëndrueshme, të harmonizuar me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe përfaqësuar me legjislacionin relevant Evropian. Korniza ligjore dhe rregullatore duhet të ofrojë dhe lejojë zhvillim progresiv të sektorit të shërbimeve të ujit, të balancojë interesat e konsumatorëve dhe të ofruesve të shërbimeve. ARRU po ashtu monitoron harmonizimin e akteve të brendshme të ofruesve të shërbimeve me rregulloret e ARRU dhe kornizës ligjore të aplikueshme.

ARRU gjatë hartimit të kornizës ligjore dhe rregullatore mëton të vendosë një balancë midis të drejtave dhe përgjegjësi të konsumatorëve në njërin anë dhe të ofruesve në anën tjetër, monitoron përmbushjen e standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe mbështetë ofruesit e shërbimeve atëherë kur konsumatorët ndërhyjnë jashtë ligjshëm në infrastrukturë apo keqpërdorin shërbimet e ofruesve publik. Në këtë funksion, ARRU do të jetë tejet e angazhuar në monitorimin e procesit të zgjidhjes së drejtë të ankesave të konsumatorëve; pra monitorimin e punës së Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve të Shkallës së Parë – KZAK Sh 1 që funksionon në kuadër të strukturës së KRU-ve. Konsumatorët e pakënaqur me vendimmarrje në KZAK Sh 1, apelojnë vendimet dhe ankohen në Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve të Shkallës së Dytë – KZAK Sh 2, i krijuar në ARRU. KZAK Sh 2 shqyrton ankesat e konsumatorëve brenda afateve ligjore dhe merr vendime meritore. Konsumatorët apo ofruesit e shërbimeve, të pakënaqur me vendimet e KZAK Sh 2, kanë të drejtë ankese në Gjykata.

Asnjë ofruesve i shërbimeve që ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura, furnizimit të uji të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Republikën e Kosovës nuk mund të ofrojnë këto shërbime pa pasur licencë të shërbimit. Në pajtim me nenin 4.3.1 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) është kompetent për licencimin e ofruesve të shërbimit që ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura, furnizimit të uji të

përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Republikën e Kosovës dhe ndërmerr masa në rast të shkeljes apo/ose mos respektimin e Licencës së Shërbimit.

Synimi Strategjik 2: Menaxhimi dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e infrastrukturës së shërbimeve të ujit sigurohet përmes procesit tarifor

Ky synim strategjik është planifikuar të realizohet përmes tre objektivave vijues:

- Objektiva 1: Planet strategjike të ofruesve të shërbimeve janë rishikuar dhe aprovuar nga ARRU
- Objektiva 2: Tarifat e shërbimeve të ujit mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të asetëve të ofruesve të shërbimeve dhe janë të përballueshme për konsumatorët
- Objektiva 3: Kryerja e analizave, hulumtimeve dhe publikimi i raporteve që derivojnë nga procesi tarifor

ARRU ligjërisht është e mandatuar të aprovojë dokumentet (planet) zhvillimore të ofruesve të shërbimit. Aprovimi i këtyre dokumenteve / planeve ndërlidhet me investimet kapitale të cilat janë subject i aprovimit të ARRU.

ARRU bën përcaktimin dhe aprovimin e tarifave për shërbimet e ujit, në pajtim me legjislacionin në fuqi duke u bazuar në praktikën e mira rregullatore. Tarifat e aprovuara sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorët, duke pasur parasysh shëndetin publik dhe mjedisin.

Në anën tjetër, pjesë e aprovimit të tarifave nga ARRU është edhe analiza e përballueshmërisë së tarifave për qytetarët e Kosovës. ARRU monitoron në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e procesit tarifor dhe vë në focus monitorimin e përmbushjes së çaqeve të cilat janë aprovuar përmes procesit tarifor.

Synimi Strategjik 3: Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimeve kundrejt çaqeve të aprovuara, udhëhequr në praktikën e benchmarkingut dhe konkurrencës

Ky synim do të përmbushet përmes tre objektivave të definuara dhe formuluar në tekstin në vijim:

- Objektiva 1: Lista e treguesve kyç të performancës për matje të progresit, performancës dhe konkurrencës midis ofruesve të shërbimeve është definuar
- Objektiva 2: Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara financiare dhe operative nga ofruesit e shërbimeve është verifikuar dhe audituar
- Objektiva 3: Kryerja e analizave, hulumtimeve dhe publikimi i raporteve që derivojnë nga procesi i verifikimit të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve (treguesit operativ dhe financiar)

Monitorimi dhe vlerësimi kritik i performancës së ofruesve të shërbimeve është një prej përgjegjësi funksionale të ARRU. Për të menaxhuar me procesin e monitorimit dhe raportimit të performancës së ofruesve të shërbimeve, ARRU përdorë një numër të mjeteve rregullatore, përfshirë para caktimin e çaqeve me qëllim të sfidimit të ofruesve të shërbimit për të përmirësuar performancën e tyre. ARRU mbledh të dhënat e përgjithshme dhe specifike prej ofruesve të shërbimeve, i auditon/ verifikon dhe i proceson ato të dhëna dhe publikon raportet rregullatore çdo vit lidhur me gjendjen e sektorit dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Përmes vlerësimit të përgjithshëm të arritjeve, komenteve dhe publikimit të përmbledhjes vjetore të performancës së ofruesve të shërbimeve për secilën nga fushat kryesore që ndikojnë në rezultatet

kryesore për konsumatorë, mjedisin, si dhe gjendejen financiare të kompanive, ARRU do të vazhdojë të zhvillojë dhe avancojë edhe më tej sistemin e kontrollit dhe monitorimit të shërbimeve të ofruara.

ARRU përmes monitorimit të performancës synon të krahasojë ofruesit e shërbimeve se në çfarë mase i kanë përmbushur caqet e planifikuara, krahason performancën e KRU-të në Kosovë me performancën e kompanive të ngjashme në regjion dhe Evropë, bën analiza me qëllim që t'u ofrojë KRU-ve udhëzime për përmirësim në fushat në të cilat ka pasur ngecje. Matja dhe vlersimi i performancës së KRU-ve, bëhet sipas udhëzuesit dhe metodologjisë së përvetsuar nga ARRU, e cila është në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare dhe që është e aplikueshme edhe nga agjencionet rregullatore në regjion dhe Evropë.

Publikimi i Raporteve Vjetore të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, përveç që është një burim i rëndësishëm i informacionit për sektorin e ujit në Kosovë, bëhet me qëllim për të demonstruar transparencë në sektor, për të promovuar përgjegjshmërinë menaxhuese të ofruesve të shërbimit të ujit dhe për të inkurajuar përmirësime progresive të performancës.

Synimi Strategjik 4: Monitorimi dhe inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe besueshmërisë së të dhënave

Ofrimi i shërbimeve të ujit sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi është obligim kryesor i ofruesve të licencuar të shërbimeve (KRU) dhe përmbushja e tyre përveç ndikimit në shëndetin dhe mirëqenien e konsumatorëve ka ndikim të drejtpërdrejt edhe në mbrojtjen e ambientit. Prandaj ARRU në vazhdimësi mbikëqyr, mbështet dhe nxit KRU-të për përmbushjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve e ofruara.

Për arritjen e këtij qëllimi ARRU zhvillon aktivitete të ndryshme ndër të cilat është edhe vlerësimi i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimeve bazuar në të dhënat e inspektuara. Inspektimi është një aktivitet periodik, po dhe mekanizëm në dorë të ARRU-së, për të obliguar KRU-të të ofrojnë shërbime në pajtueshmëri me standardet e vendosura të shërbimit.

Në këtë aspekt, janë përpiluar Modulet e veçanta për secilën KRU për ruajtjen dhe rifreskimin e të dhënave dhe informacioneve të inspektuara dhe të njëjtat janë përpunuar në tregues konkret. Këto Module i shërbejnë ARRU-së si vegël për monitorimin e nivelit të shërbimeve të ofruara nga KRU kundrejt standardeve dhe rregullave të përcaktuara, si dhe të identifikojë mangësitë dhe vështirësitë e hasura për secilën KRU.

Prandaj ARRU do të angazhohet që përmes inspektimeve më të detajuara për standardet të cilat kanë rezultuar me mangësi në përmbushje, rekomandimeve përkatëse, konsultimeve me menaxhmentin e KRU-ve, si dhe përmes ndërmarrjes së masave tjera konkrete të cilat janë të parapara me legjislacionin në fuqi, të i nxisë KRU-të për përmirësim të vazhdueshëm.

Përmbushja e këtij synimi është planifikuar të realizohet përmes objektivave vijuese:

- Objektiva 1: Organizimi i inspektimeve tek ofruesit e shërbimeve për të verifikuar nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit
- Objektiva 2: Kryerja e analizave dhe publikimi raporteve që derivojnë nga inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit

Synimi Strategjik 5: Nxitja e zhvillimit institucional të ARRU-së, mirëmbajtja dhe krijimi i partneritetit për t'u përballur me sfidat në rritje të sektorit

ARRU, ka si prioritet mbështetjen e stafit për të marrë pjesë në trajnime në fushat që janë me interes për shërbimet e ujit, si: monitorimi i standardeve të shërbimeve, monitorimi i performancës, përcaktimi i tarifave, aspektet ligjore të rregullimit të shërbimeve të ujit, etj. Pjesëmarrja në trajnime dhe ngritja profesionale e stafit është thelbësore për zhvillimin e institucionit të ARRU-së.

Një tjetër fushë kritike që është identifikuar nga ARRU është komunikimi transparent ndër-institucional. ARR do të vazhdojë të promovojë bashkëpunimin konstruktiv të gjithë akterëve të sektorit të ujit në Kosovë. ARRU beson se bashkëpunimi i mirë dhe transparent i të gjitha institucioneve do të kontribuonte në avancimin e sektorit të ujit në Kosovë. Gjendja jo e mirë e sektorit, në masë të madhe është si pasojë edhe e mos koordinimit të mjaftueshëm të veprimeve të institucioneve përgjegjëse.

Një tjetër fokus i ARRU është mirëmbajtja e raporteve dhe komunikimit me institucionet ndërkombëtare, në radhë të parë me WAREG dhe me institucionet tjera ndërkombëtare me të cilat duhet të dakordohen dhe orientohen investimet në infrastrukturën e ujit në Kosovë.

Një çështje tjetër me rëndësi nga këndvështrimi i ARRU-së është gjendja e pandryshuar për sa i përket integritetit të sistemeve rurale dhe urbane nën menaxhimin e KRU-ve të licencuara. Këto sisteme po vazhdojnë të degradohen si rezultat e operimit dhe mirëmbajtjes jo profesionale. ARRU, në kuadër të përgjegjësisë së saj ligjore, do të mbështesë çdo iniciativë që ka për qëllim integrimin e sistemeve nën kupolën e KRU-ve dhe zgjerimin e zonës së shërbimit.

Zbatimi i këtij synimi strategjik do të përmbushet përmes 4 (katër) objektivave të listuar në vijim.

- Objektiva 1: Ngritja profesionale dhe institucionale e ARRU-së si autoritet i pavarur, i pa anshëm për rregullim shërbimeve të ujit
- Objektiva 2: Promovimi i komunikimit ndër-institucional me të gjitha palët e interesit për të identifikuar sfidat dhe për të avancuar reformimin dhe zhvillimin e sektorit të ujit
- Objektiva 3: Avancimi i komunikimit me rregullatorët dhe institucionet tjera ndërkombëtare për të ndarë përvojat dhe praktikatat e mira rregullatore për zhvillim të sektorit të ujit
- Objektiva 4: Mbështetja e integritetit të sistemeve rurale dhe urbane nën menaxhim të ofruesve të licencuar të shërbimeve

Synimi Strategjik 6: Sigurimi i qëndrueshmërisë operative dhe financiare të ARRU

Për realizimin e këtij synimi është definuar vetëm një objektive, siç është emërtuar më poshtë.

- Objektiva 1: Planifikimi dhe administrimi operativ dhe financiar i institucionit të ARRU-së

Roli kryesor i Departamentit të Administratës dhe Financave është mbështetja e funksionimit dhe monitorimi i brendshëm i ARRU-së si institucion duke përkrahur departamentet dhe njësinë në ARRU në aspektet administrative, financiare, materiale dhe logjistike në arritjen e synimeve dhe objektivave të parapara me ligj.

Ky departament **odhet** të koordinojë veprimet e ARRU-së me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për sa i përket burimeve njerëzore dhe çështjeve të tjera relevante, po ashtu duhet të koordinohet edhe koordinojë me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për çështje të raportimeve financiare, prokurimit për mallra dhe shërbime për nevoja të funksionimit të ARRU-së.

3 MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT

Plani i veprimit për zbatim të Planit Strategjik 2024 – 2026 të ARRU, që përfshinë planin kohor

Nr.	Synimi Strategjik	Aktivitetet e planifikuara	Roli		Afati kohor i zbatimit						Tregues i matjes	Sfidat / Shkalla e rrezikut	
			Bartës	Mbështetës	2024		2025		2026				
					H1	H2	H1	H2	H1	H2			
Synimi Strategjik 1	Korniza ligjore dhe rregullative është në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm të ofruesve të shërbimeve dhe e balancuar me kërkesat e konsumatorëve	Objektiva 1: Korniza ligjore dhe rregullatore kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit											
		1-1.1	Rishikimi, avancimi dhe zhvillimi i kornizës ligjore të ARRU-së dhe të ofruesve të shërbimeve të ujit me qëllim të ngritjes së standardeve të shërbimit dhe përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian	ARRU/ DL&ÇL, Kuvendi i Kosovës	KRU, MeE, palët e interesit	x	x	x	x	x	x	- Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të aprovuara	Mos miratimi në kohë i kornizës së propozuar ligjore - Rreziku i lartë deri mesatar
		1-1.2	Monitorimi i zbatimit të kornizës ligjore dhe plotësimit të kushteve të licencës nga ofruesit e shërbimeve	ARRU/ DL&ÇL, Kuvendi i Kosovës	KRU, MeE, MINT, palët e interesit	x	x	x	x	x	x	- Shkresat, paralajmërimet dhe vendimet për shkelje të kornizës ligjore dhe mos plotësim të kushteve të licencës	Mos zbatim i kornizës ligjore dhe kushteve të licencës - Rreziku i lartë deri mesatar
		Objektiva 2: Monitorimi dhe zbatimi i politikave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve											
		1-2.1	Avancimi dhe zbatimi i politikave institucionale, që i'u garanton konsumatorëve mbrojtje ligjore për të drejtat e tyre	ARRU/ DL&ÇL	KRU, Konsumatorët	x	x	x	x	x	x	- Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të aprovuara që adresojnë të drejtat e konsumatorëve	
		1-2.2	Trajtimi, zgjidhja dhe vendimmarrja për ankesat të konsumatorëve në mënyrë të drejtë dhe profesionale.	ARRU/ DL&ÇL	KRU, Konsumatorët	x	x	x	x	x	x	- Raportet për numrin e ankesave të shqyrtuara nga KZAK – Sh 1 - Numri i vizitave tek KRU-të për të	Mos shqyrtimi në kohë i ankesave të konsumatorëve - Rreziku i ulët

											monitoruar punën e KZAK – Sh 1		
		1.2-3	Ngritja e nivelit të përfaqësimit profesional, në procese gjyqësore.	ARRU/ DL&ÇL	KRU, Konsumatorët, Gjykata	x	x	x	x	x	x	- Numri i seancave gjyqësore për shqyrtim të ankesave të palëve ankuese	Mbajtja e seancave gjyqësore - Rrezik i ulët
Objektiva 3: Monitorimi i zbatimit të kushteve të licencës të ofruesve të shërbimeve të ujit													
		1-3.1	Hartimi i raporteve rreth përmbushjes së kushteve të licencës, raporteve të ankesave dhe nivelit të zgjedhjes së ankesave nga KZAK SH1 dhe KZAK Sh 2	ARRU/ DL&ÇL	/	x		x		x		- Raportet për përmbushje të kushteve të licencës dhe punës së KZAK janë hartuar dhe publikuar	Është aktivitet nën kontrollë të plotë të ARRU-së - Rreziku i ulët
		1-3.2	Organizimi i hulumtimit për matje të kënaqshmërinë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve	ARRU/ DL&ÇL		x		x		x		- Raporti i hulumtimit të kënaqshmërisë së konsumatorëve	Është aktivitet nën kontrollë të plotë të ARRU-së - Rreziku i ulët

Nr.	Synimi Strategjik	Aktivitetet e planifikuara	Roli		Afati kohor i zbatimit						Tregues i matjes	Sfidat / Shkalla e rrezikut	
			Bartës	Mbështetës	2024		2025		2026				
					H1	H2	H1	H2	H1	H2			
Synimi Strategjik 2	Menaxhimi dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e infrastrukturës së shërbimeve të ujit sigurohet përmes procesit tarifor	Objektiva 1: Planet strategjike të ofruesve të shërbimeve janë rishikuar dhe aprovuar nga ARRU											
		2-1.1	Plani i Biznesit është hartuar nga ofruesit e shërbimeve dhe aprovuar nga ARRU	KRU	MeE (NjPMNP), ARRU		x		x		x	- Plani i Biznesit i hartuar, i aprovuar dhe i publikuar ne web-faqe te KRU-ve	PB i hartuar nga KRU nuk është aprovuar nga ARRU - Rreziku i mesatar
